KËRKESË
Nr. 796/16, datë 4.8.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Pastrim i kolektorit nga rruga 'Demokracia' deri tek rruga 'Vasil Puka', Bashkia Vlorë'".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

1. Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit "truall+ndërtesë", bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave", dhe vlerësimi i pasurisë së llojit "ndërtesë" është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 138, datë 3.2.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë për interes publik", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit pranë Bashkisë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është prej 1,732,845 (një milion e shtatëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e dyzet e pesë lekë).

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PASTRIMI I KOLEKTORIT NGA RRUGA 'DEMOKRACIA' DERI TEK RRUGA 'VASIL PUKA', BASHKIA VLORË"

Pronari		Të dhëna hipotekore								Vlerësimet për shpronësim							
										Truall			Ndërtesë				
Nr.	Emër/Mbiemër	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë /m²)	Vlera (lekë)	Vlera totale (lekë)	Shënime
1	Fatmira Canaj (Fataj) Kimet Fataj Gezime Koço (Fataj) Servet Fataj Petrit Fataj Hava Fataj Qerem Fataj	8605	37/118	Truall dhe ndërtesë	35	35	35	18	133	1	8300	8,300	35	32,625.29	1,141,885	1,150,185	Duke qenë objekt i llojit jobanimi, në bazë të VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, llogaritjet janë bërë me situacion punimesh. Seksioni E: Lokal 2-katësh me leje ndërtimi me ref. 07664. Aktualisht objekti është 1-katësh.
2	Artur Dhamo	8605	38/32	Truall	219	219	0	11	9	24.3	8300	201,690	0	0	-	201,690	
3	Hysen Bimo Kadri Bimo	8605	38/6	Truall	120	120	0	14	142	45.9	8300	380,970	0	0	-	380,970	Seksioni D: Me nr. 0006598 datë 10.7.2006. Mungon e dëshmia e trashëgimisë e Zenel Bimo.
	VLERA PARAPRAKE														-	**1,732,845**	